



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 02
Prishtinë, më 25.5.2021, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Verica Ceraniq, kryetare e komisionit; Hydajet Hyseni dhe Bahrim Shabani, zëvendëskryetarë. Anëtarë të tjerë: Drita Millaku, Arjeta Fejza, Elmi Reçica, Shemsedin Dreshaj, Miljana Nikoliq, Zoran Mojsilović, Jasmina Dediq, Milosh Perović, Enis Kervan, Adem Hoxha, Fadil Gashi, Fridon Lala dhe Bekim Arifi.

Munguan: Behxhet Pacolli dhe Ivan Todosijević.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: Liridona Gashi, këshilltare politike e KRK; Rashat Nurboja, këshilltar politik i kabinetit të KK; Qazim Ramadani, KK; Liridon Gashi, GP/PDK; Fitore Berisha, Ekonomia online; Zijush Ahmeti, zyrtar nga SKKK dhe Celal Iliaz, Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi **Verica Ceraniq**, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 5.5.2021;**
- 3. Shqyrtimi dhe miratimi i draft- planit të punës së Komisionit, për vitin 2021;**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Verica Ceraniq, kryetare, fillimisht i informoi anëtarët e komisionit, se Kuvendi i Republikës së Kosovës, në seancën plenare, të mbajtur më 20.05.202, ka nxjerrë vendimin për formimin i komisioneve parlamentare, i cili ka ndryshuar vendimin e datës 2.04.2021. Me këtë vendim, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, plotësohet me 6 deputetë. Kryetarja konstatoi, se në këtë mandat, komisioni përbëhet prej 18 anëtarëve.

Fjalën për prezantim ua dha anëtarëve të rinj të komisionit.

Drita Millaku, anëtare e GP/VV, tha se është mandati i parë i saj, si deputete. Po ashtu, konsideron se do të kontribuojë në mënyrë të paanshme, në ngritjen e çështjeve në aspektin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve. Më tej, u shpreh se në këtë kontekst, ngase me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, garantohet përfaqësimi i barabartë i komuniteteve.

Arjeta Fejza, anëtare e GP/VV, deputete, për herë të parë, uron komisionin të ketë bashkëpunim të mirë, në të gjitha fushat. Angazhimi i saj do të jetë respektimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në bazë të së cilës garantohet gjithëpërfshirja e komuniteteve.

Adem Hoxha, përfaqësues i komunitetit goran, për herë të tretë anëtar në këtë komision, përshëndeti të pranishmit, njëherësh uroi përzgjedhjen e kryetares, si kryesuese e komisionit. Po ashtu, mendon se do të ketë bashkëpunim të mirë në realizimin e çështjeve që kanë të bëjnë me të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Milosh Peroviq, anëtar i Listës Serbe / LS, në mandatin e kaluar, ishte anëtarë në këtë komision. Edhe në këtë mandat, do të angazhohet në zhvillimin e çështjeve të cilat do të jenë në dobi të interesave të komuniteteve.

Jasmina Dediq, anëtare e Listës Serbe / LS, për herë të parë, anëtare e komisionit. Mendon se puna në komisionit do të jetë konstruktive, në kudër të trajtimit të çështjeve në të mirë të komuniteteve.

Fadil Gashi, përfaqësues i komunitetit rom, deputet për herë të parë, beson se do të punohet në të mirë dhe në interes të të gjitha komuniteteve.

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës miratohet, njëzëri, pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 5.5.2021

Kryetarja hodhi në votim procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më datë 5.5.2021.

Drita Millaku, theksoi se unë dhe kolegja e partisë së njëjte, sa i përket miratimit të procesverbalit, vota jonë është e përmbajtur, ngase nuk kemi marrë pjesë në mbledhjen paraprake të komisionit, kjo është arsyeja e vetme.

Kryetarja, theksoi se në takimin paraprak, në rend dite ka qenë konstituimi i komisionit dhe nuk janë shtjelluar tema të tjera.

Kryetarja konstatoi se komisioni, me shumicë të votave, miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 5. 5.2021, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-planit të punës së Komisionit, për vitin 2021

Kryetarja konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim është komision i përhershëm, ku shqyrtohen çështjet që kanë të bëjnë me promovimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve.

Më tej, konsideroi se anëtarët e komisionit e kanë marrë me kohë draft-planin e punës për vitin 2021, në formë elektronike. Draft-planin e punës përbëhet nga dy pjesë: pjesa tekstuale dhe tabelore, me përmbajtjen e detyrave dhe obligimeve të komisionit në periudha të caktuara. Kërkoj nga anëtarët e komisionit të paraqesin propozimet apo sugjerimet e tyre eventuale.

Elmi Reçica, theksoi se e ka analizuar draft-planin e punës për vitin 2021 dhe konsideroi se i njëjti është hartuar mirë dhe i plotëson kushtet për punë.

Mirëpo, kishte disa sugjerime konkrete, të cilat ndërlidhen me punën e komisionit.

Përveç raportimeve të ministrave të linjës dhe të institucioneve tjera, propozoi të ftohet në raportim zëvendëskryeministrja për Çështje të Pakicave dhe të Drejtat e Njeriut, meqë është organi më i lartë ekzekutiv në Republikën e Kosovës. Njëkohësisht, propozoi të ftohet në takim ministri i Ministrisë për Zhvillim Rajonal.

Enis Kervan, ishte i mendimit se plani i punës është hartuar mirë, por ka nevojë të plotësohet me disa propozime konkrete.

Kur bëhet fjalë për zbatimin e ligjeve, pajtohet që të monitorohet Ligji për vetëqeverisje lokale.

Po ashtu, konsideron se përfaqësimi i komuniteteve është i ndërlidhur edhe me ligjet bazike, të cilat duhet të jenë pjesë e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve.

Propozimi i tij ishte që të monitorohet Ligji për gjuhët, me arsye se komuniteti jo shumicë has në probleme gjatë zbatimit të tij, si në nivel qendror, ashtu dhe në nivel lokal.

Nën dy, të monitorohet Ligji për shërbimin civil të Republikës së Kosovës. Neni 11 i ligjit rregullon përqindjen e kuotës në nivel qendror, minimum 10% të pozitave për punësim të cilat rezervohen për komunitetet, të cilët nuk janë shumicë në Kosovë.

Në nivelin komunal, është i rezervuar numri i vendeve të punës, në pajtim me përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në atë komunë. Lidhur me këtë çështje, ai dha sqarim se qytetarët hasin në probleme të shumta gjatë procedurave të punësimit, ngase shumica e tyre flasin dy gjuhë dhe padrejtësisht ia zënë vendin tjetrit.

Si propozim tjetër, të monitorohet Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, i cili ligj është Kushtetuta e dytë, për komunitetin jo shumicë.

Gjithashtu, diskutoi se komuniteti jo-shumicë dhe jo-serb, rregullisht has në probleme me tekste shkollore dhe me arsimin parauniversitar. Andaj, kërkoi që të përfshihet në plan të punës, Ligji për Arsimin parauniversitar.

Kryetarja, theksoi se në plan të punës, në muajin korrik, është planifikuar të ftohet ministri për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, ku mund të diskutohen ligjet e propozuara.

Sa i përket propozimeve dhe sugjerimeve të anëtarëve të komisionit, si pikë e veçantë e rendit të ditës, do të caktohet rishqyrtimi i planit të punës për tremujorin e parë të vitit 2021.

Shemsedin Dreshaj, mendon se plani i punës për vitin 2021, është hartuar mirë, në tërësi.

Sa i përket vizitave në terren dhe takimeve me organizatat ndërkombëtare, ai ka dy propozime: kur bëhet fjalë për vizitat e parapara në kuvendet komunale, është mirë të planifikohet kontakti me qytetarët e komunave të caktuara, me qëllim që të dëgjohen kërkesa e tyre.

Propozimi tjetër i tij ishte, të specifikohen takimet me organizatat ndërkombëtare të cilat janë me më influencë, si p.sh. USAID-i dhe organizata tjera, ku do të ofrohet mundësia të përfitohen mjete materiale, me ç’ rast do t’ju përmirësohet jeta e komuniteteve.

Hydajet Hyseni, shprehu qëndrimin e tij se pajtohet për miratimin e planit të punës për vitin 2021, duke konsideruar se i njëjti do të plotësohet dhe ndryshohet, në takimin e radhës.

Ishte i mendimit, që të organizohen tryeza të rrumbullakëta, me qëllim që të vihet komunikimi me vendet fqinje, me qëllim të shkëmbimit të përvojave, në dobi të avancimit dhe përmirësimit të jetës së komuniteteve. Në bazë të praktikave të më hershme, është treguar si përvojë e mirë, andaj propozoi të përpilohet një broshurë në tri gjuhë, shqip, serbisht dhe turqisht.

Kryetarja shprehu qëndrimin e saj, se Komisioni do të miratojë planin e punës për vitin 2021, në formën të cilën e kemi para vetes. Më tej, tha se në takimin e radhës, komisioni do të rishqyrtojë planin e punës për tremujorin e parë të vitit 2021, me mundësi që të përcaktohen prioritetet, siç janë: të ftohet ministri i resorit përkatës dhe ministrat tjerë, mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve, mbikëqyrja e institucioneve relevante dhe vizitat në terren.

Kryetarja konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxori këtë:

Përfundim

- 1. Miratohet plani i punës së komisionit për vitin 2021, i cili është hartuar në bazë të Strategjisë Legjislative të Qeverisë për vitin 2021, të objektivave të programit të Qeverisë dhe në bazë të përgjegjësiave të Komisionit, që janë në kompetencën e tij.*
- 2. Në takimin e radhës do të rishqyrtohet plani i punës për tremujorin e parë, me mundësi që të inkorporohen propozimet dhe sugjerimet e anëtarëve të komisionit.*

Mbledhja përfundoi në orën 13:40.

Përgatitur nga:

Njësia mbështetëse e Komisionit.

Verica Ceraniq

Kryetare e komisionit,